# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441781**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/te-shtena-me-arme-prane-nje-lokali-ne-greqi-dyshohet-se-eshte-i-perfs-i103961` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 21:27:46 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 21:18:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `764294a955feec2dcbc49a77f52935ec087d17408c513d227a2dd2908360637e` |
| TEKSTI | `7f5aeb65c01618f4c4ef65c5da93ce09744c5503749d9b23d9075fd1e6f29d74` |
| PAMJA | `37489d4d42b87d1d4b2ab6f041dc51164497e4187ac4a2b78898e30ff70d5bc1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e4d11e0428344c9e1bfbf4311d9624bb237c47e73bb0d3ade3f5a2439dd21dc9` |
| E MËPARSHMJA | `4596d35777cc379fae0621457fc3fe79fcc8add6a428b774375c70e171d8976d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e4d11e0428344c9e1bfbf4311d9624bb237c47e73bb0d3ade3f5a2439dd21dc9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai

Piranjat Përditësimi i fundit 13 Shtator 2026, 23:18



Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë me helikopter nga burgu, rezulton të jetë një prej personave të përfshirë në incidentin me të shtëna me armë zjarri në një bar plazhi në Anavyssos të Athinës.

Ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit të sotëm, ndërsa identifikimi i Rizait u bë pas analizimit të pamjeve filmike nga policia, të cilat autoritetet arritën t'i shqyrtonin vetëm gjatë orëve të pasdites.

Sipas mediave greke, Rizai ndodhej në leje nga Burgu i Domokos, ku duhet të rikthehet mëngjesin e së hënës. Në rast se nuk paraqitet në burg, ai do të shpallet i arratisur, ndërsa policia greke ka nisur mobilizimin për lokalizimin e tij.

Sipas mediave greke, policia mori një telefonatë për të shtëna në zonën e Anavyssos rreth orës 05:15 të mëngjesit. Kur efektivët mbërritën në vendngjarje, nuk gjetën persona, por vetëm dy gëzhoja dhe njolla gjaku.

Pak më vonë, policia u njoftua nga Qendra Shëndetësore e Kalivias se dy persona ishin paraqitur për ndihmë mjekësore. Bëhet fjalë për një 20-vjeçar grek, i cili kishte marrë një plagë nga fragmentet e xhamit në kyçin e këmbës, dhe një 41-vjeçar pakistanez, i cili kishte marrë një plagë plumbi në pulpë.

Të dy rezultuan të ishin punonjës të biznesit dhe u morën në pyetje nga autoritetet. Megjithatë, sipas policisë, dëshmitë e tyre nuk përputheshin me njëra-tjetrën, ndërsa versione të ndryshme për ngjarjen ka dhënë edhe pronari i lokalit.

Nga hetimet paraprake dyshohet se gjithçka nisi pasi shumica e klientëve ishin larguar nga lokali dhe pronari kishte ulur muzikën. Në atë moment, Rizai, i cili ndodhej aty së bashku me dy persona të tjerë, doli në parking dhe vendosi muzikë me zë të lartë në automjetin e tij.

Pronari i biznesit doli jashtë dhe i kërkoi ta ulte zërin, pasi kishte frikë se zhurma mund të shkaktonte ndërhyrjen e policisë. Situata më pas u përshkallëzua në një konflikt, ku u përfshinë edhe persona të tjerë që dolën nga lokali.

Gjatë përplasjes, Rizai dyshohet se nxori një armë dhe qëlloi në ajër. Më pas, edhe një shtetas afgan, i cili kishte dalë nga lokali dhe dyshohet se punonte si pjesë e sigurisë së biznesit, hapi zjarr.

Nga të shtënat, plumbat dyshohet se kanë bërë rikoshet dhe kanë plagosur dy punonjësit e lokalit.

Pas incidentit, Alket Rizai dhe dy personat që e shoqëronin hipën në automjet dhe u larguan me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Edhe shtetasi afgan, i cili tashmë është në kërkim nga autoritetet greke, u largua.

Ndërkohë, pronari i biznesit është arrestuar deri më tani, pasi dyshohet se ka dhënë deklaratë të rreme në lidhje me rrethanat e incidentit.

Ngjarja ka vënë në lëvizje policinë greke, e cila po kërkon të lokalizojë Rizain përpara përfundimit të lejes së tij dhe rikthimit të parashikuar në burgun e Domokos.

# Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 13 Shtator23:04

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë në oborrin e banesës]

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

AKTUALITET 13 Shtator22:16

“Rama na preu në besë”/ Dita e 45-së e protestës, Divjaka kundër Territoriales: Nuk pranojmë të bashkohemi me Lushnjen

Divjaka vijon protestën kundra projektit të PS për shkrirjen e bashkisë dhe kalimin në varësi të Lushnjes. Identiteti, hist...

AKTUALITET 13 Shtator20:55

KPP merr fuqi mbi koncesionet: Mund t’i pezullojë menjëherë ose...

Kontratat koncesionare dhe partneritetet publik-privat do të kalojnë nën një kontroll më të fortë administrativ, pasi ...

AKTUALITET 13 Shtator18:18

Përmbytjet në Elbasan, banorët kërkojnë ndihmë: Na gjeni strehim

Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar përmbytje dhe probleme të shumta në qytetin e Elbasanit. Brenda vetëm 30 minutash, rr...

AKTUALITET 13 Shtator17:36

“Dje thonte furnizojmë vendet në konflikt, sot premton se do të prodhojmë armë”/ Këlliçi nxjerr zbuluar ministrin Nufi: Ermal Raketa flet për trafik apo…

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi ka “nxjerrë zbuluar” ministrin e Mbrojtjes Ermal Nufi. Në një...

AKTUALITET 13 Shtator16:48

Përleshje mes 15 personash në Athinë, plagoset 40-vjeçari. Në pranga shqiptari dhe dy të tjerë

Një përleshje e dhunshme ku përfshiheshin afërsisht 15 persona u regjistrua të shtunën në Athinë, Raportohet se pas ngja...

AKTUALITET 13 Shtator16:44

“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Territorialen”, Egla Ceno flet për përballjen me kryeministrin: Ai u çua i irrituar edhe...

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator16:22

Digjet pjesërisht një banesë në Fushë-Krujë, flakët shkrumbuan çatinë

Një banesë është përfshirë nga flakët në lagjen “Kastrioti” në Fushë-Krujë. Banesa, në p...

AKTUALITET 13 Shtator15:34

Zbulohet pse “Çunat e Londrës” po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon pronat e konfiskuara

Gazeta britanike Daily Mail i ka kushtuar një reportazh të gjatë të ashtuquajturve “Çunat e Londrës”, duke u fokusua...

AKTUALITET 13 Shtator15:06

Aksident në aksin Qishbardhë-Peshkëpi, përplasen dy makina, disa të plagosur

Një aksident rrugor është regjistruar ditën e sotme në aksin Qishbardhë-Peshkëpi, ku dy automjete janë përplasur me...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 13 Shtator

“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Terri...

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

[**A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...**]

Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

SHOWBIZ 13 Shtator

[**"Ishte një ndërhyrje delikate dhe e vështirë", ...**]

Moderatori Bledi Strakosha ka ndarë me ndjekësit e tij një nga periudhat më të vështira të jetës, ai ka kaluar një ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video




## Reagon Cllevio!




**Reagon Cllevio!**



**Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!**






**Deklarata e Gjestit!**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.